



AL

**ELENCO ASSISTENZE**

VERSIONE ALBANESE

## **PËRMBLEDHJA E SHËRBIMEVE TË PARASHIKUARA NGA KONTRATA KOMBËTARE PROVINCIALE**

### **• SHPËRBLIMI PËR KRISHTLINDJET DHE PUSHIMET**

(pagesa e kuotave të vëna mënjanë të Industrisë Ndërtimore)

Gusht: periudha e likuiduar nga tetori në mars

Dhjetor: periudha e likuiduar nga prilli në shtator

### **MËNYRAT E PAGESËS:**

- nëpërmjet **urdhërshirimit në llogarinë rrjedhëse bankare ose postare**, për punonjësit që i kanë komunikuar të dhënat e llogarisë së tyre bankare. Punonjësit do të njoftohen me anën e një letre e cila përmban të dhënat në lidhje me pagesën dhe valutën e urdhërshirimit, pra datën nga e cila do të vihet në dispozicion shuma e paguar në llogarinë rrjedhëse bankare;

- nëpërmjet **urdhërshirimit me adresë pranë Postave Italiane** (për punonjësit që nuk i kanë komunikuar të dhënat në lidhje me llogarinë e tyre bankare). Punonjësit do të njoftohen me anën e një letre e cila përmban të dhënat në lidhje me pagesën dhe periudhën në të cilën shuma do të jetë e disponueshme.

Për tërheqjen e shumës personi i interesuar duhet të shkojë personalisht në një Zyrë Poste me një letërnjoftim të rregullt dhe taserën e kodit fiskal.

### **• SHËRBIM I RI NË FAVOR TË PUNËTORËVE TË NDËRMARRJEVE TË FALIMENTUARA**

#### **• ASISTENCA:**

Vizita okulistike dhe blerje e protezave – Proteza dentare, ortopedike, ortofonike – Shpërblim për punëtorët e rinj për fillimin e aktivitetit në ndërtim - 150 orë për punëtorë studentë – Rimbursim i shpenzimeve mësimore – Bursa studimi – Kampe verore për fëmijë dhe adoleshentë – Ndihmë për pensionin - Shpenzime funerale për të afërm të shkallës së parë – Shpenzime funerale për punëtor të regjistruar – Ndihma të jashtëzakonshme - Pagesa e shpenzimeve për çerdhet.

Përfituesit e këtyre asistencave: punëtori i regjistruar dhe, në se është pagues taksash, përfitojnë edhe bashkëshortja me fëmijët e tij.

Kërkesa duhet të paraqitet brenda 90 ditëve nga data e lëshimit të faturës ose brenda 90 ditëve nga verifikimi i ngjarjes.

#### **• KONTRIBUT INTERESASH MBI KREDINË PËR SHTËPINË E PARË TË BANIMIT**

Taksa lehtësuese – Kontribut interesash.

#### **• VESHJE DHE KËPUCË PËR MBROJTJE NGA RREZIKU**

(furnizimi është i rregulluar nga CCPL 86-06-30)

#### **• SIGURIM PËR AKSIDENTET JASHTË PROFESIONIT**

#### **• NDIHMË PËR AKSIDENTET NË PUNË (3 DITËT E PARA)**

#### **• NDIHMË PËR SËMUNDJE NË DITËT E MUNGESAVE**

#### **• PENSION SUPLEMENTAR**

#### **• EDILCARD (Karta-Edil.)**

#### **• VJETËRSIA PROFESIONALE NË SEKTORIN E NDËRTIMIT**

Nga kjo e drejtë përfitojnë punëtorët që me datën 1 Maj të çdo viti kanë të paktën 2100 orë (punë, sëmundje, fatkeqësi, leje martesore dhe ushtarake) të plotësuar në dyvjeçarin e mëparshëm, të vendosura mënjanë edhe në Arkat e ndryshme të Kursimit (Casse Edili). Për shembull: dyvjeçari i mëparshëm 1 maj 2007, nga 04-10-01 deri me 06-09-30. Çdo Arkë shlyen shumën për të cilën është kompetente. Nëse punëtori është regjistruar në disa Arka, ai duhet t'ja komunikojë këtë secilës prej tyre.